



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 430 Prot.

Tiranë, më datë 12.08 2025

VENDIM
Nr. 442, datë 12.08.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.08.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e Projektit Koncept Ide “Vlerësimi i Parkut Arkeologjik, Bylis (qytetet antike Bylis dhe Klos)” Qendrat Multifunkionale, masterplan i pikave të interesit, parkimi dhe rrethimi i sigurisë”, Brenda Kufirit Park Arkeologjik, me aplikues ABKONS dhe zhvillues **Ambasada Italiane, me rekomandimet që në Projekt Ide të reflektohen:**

- Unifikimi i titullit të projektit, në të gjithë dokumentacionin teknik dhe grafik, sipas emërimit të Termave të Referencës të miratuara nga KKTKM me Vendimin nr. 370, datë 27.09.2024;
- Funksionet e propozuara të Qendrës Multifunkionale duhet të jenë në përputhje me Planin e Menaxhimit të miratuar për Parkun Arkeologjik Bylis – Klos;
- Laboratori i konservimit duhet të jetë pjesë integrale e Muzeut Arkeologjik;
- Parkimi ‘P2’ të ketë të mirëstudiuar numrin e vendeve të propozuara, si dhe kategorinë e përdoruesve të cilëve do t’u shërbejë (P.A.K);
- Funksionet, sipërfaqet përkatëse dhe nevoja për krijimin e tyre të jenë të mirëargumentuara dhe në përputhje me Planin e Menaxhimit për Parkun Arkeologjik Bylis – Klos;
- Të plotësohet projekti me propozimin e elementëve të detajuar për rrethimin e sigurisë;
- Pjesë e projektit duhet të jetë edhe Raporti i ndikimit në Trashëgimi Kulturore dhe Arkeologji;
- Gjuha arkitektonike e propozuar duhet të ketë në fokus impaktin minimal në Pasurinë Kulturore, si dhe të minimizohet impakti nga përdorimi i pergolatave për mbulimin e hapësirave të Qendrës Multifunkionale dhe hapsirave midis objekteve;
- Propozimi për infrastrukturën prezantuese të Parkut Arkeologjik Bylis-Klos të projektohet duke pasur si qëllim një impakt sa më minimal në këtë sit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Joli MITROJORGJI

